



Republika e Kosovës
Republikë Kosova • Republic of Kosovo
Institucion i Avokatit të Popullit
Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Nr./Br./No. 1871/2022
Nr.i regjistrimit/No.
Dati/Datum/Date: 30/11/22



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucion i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

AVOKATI I POPULLIT

RAPORT

I

MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS

lidhur me vizitën në Institutin e Psikiatrisë Forenzyke

Për: **Znj. Dafina Gexha- Bunjaku, ushtruese e detyrës së ministres
Ministria e Shëndetësisë**

**Znj. Albulena Haxhiu, ministre
Ministria e Drejtësisë**

Znj. Pranvera Zejnullahu-Raci, ushtruese e detyrës së drejtoreshës së përgjithshme të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës

Kopje: **Z. Albert Zogaj, kryesues
Këshilli Gjyqësor i Kosovës**

**Z. Habit Hajredini, drejtor
Zyra e Kryeministrit - Zyra për Qeverisje të Mirë**

Prishtinë, më 30 nëntor 2022

Në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 17 të Ligjit nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës vizitoi Institutin e Psikiatrisë Forenrike të Kosovës.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalim të Torturës (më tej: MKP), bazuar në nenin 17 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, mund t'i vizitojë, në çdo kohë dhe pa paralajmërim, të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, përfshirë stacionet policore, qendrat e paraburgimit, burgjet, vendet ku mbahen të huajt e privuar nga liria, qëndrimi i të cilëve në Republikën e Kosovës bie ndesh me ligjet në fuqi dhe të cilët janë subjekt i kthimit me forcë nga Republika e Kosovës, si dhe institucionet psikiatrike dhe ato të kujdesit social.

Bazuar në këtë mandat, MKP-ja, më 26 korrik dhe më 28 shtator 2022, vizitoi Institutin e Psikiatrisë Forenrike të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: IPFK).

Qëllimi i vizitës

Qëllimi i kësaj vizite ishte vlerësimi i respektimit të të drejtave themelore të personave të cilët kanë kryer vepër penale në gjendje të paaftësishë mendore ose të aftësisë esencialisht të zvogëluar mendore, të cilët janë subjekt i urdhrit të gjykatës kompetente për trajtim të detyrueshëm psikiatrik; të personave të cilët janë subjekt i urdhrit të gjykatës për vlerësim psikiatrik me ndalim në institucionin shëndetësor; të të burgosurve që kanë zhvilluar çregullim mendor gjatë burgimit e të cilët janë vendosur në njërin nga repartet e IPFK-së, të cilat të drejta u garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës, si dhe më standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të personave të privuar nga liria.

Bashkëpunimi me MKP-në gjatë vizitës

MKP-ja, në vizitën e parë ad-hoc, e realizuar në fillim të vitit 2022, ku në ekip ishin mjeku dhe juristi i MKP-së, lidhur me disa raste individuale nuk hasën në mirëkuptim me personelin e IPFK-së, duke mos iu lejuar qasja pa marrë aprovimin e drejtorit të IPFK-së, i cili atë ditë nuk ishte në institucion.

Më 26 korrik 2022, ekipi i MKP-së realizoi vizitë të përgjithshme në IPFK, me përbërje: zëvendësi i Avokatit të Popullit, psikologu dhe punëtori social. Ekipi fillimisht u takua me një psikiatër të IPFK-së, i cili e zëvendësonte drejtorin. Ekipi pati qasje në të gjitha hapësirat e institucionit pa asnjë pengesë.

Më 28 shtator 2022, në vizitën përcjellëse, ekipi i MKP-së filloi vizitën në Repartin B për t'i intervistuar disa pacientë, përderisa drejtori nuk ishte i pranishëm në institucion. Pasi drejtori i IPFK-së u njoftua nga stafi i tij që ekipi i MKP-së ishte duke zhvilluar intervista, drejtori i IPFK-së, duke mos respektuar ligjin dhe mandatin e MKP-së, pra të drejtën për realizim të vizitave pa paralajmërim në të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, e pengoi vizitën duke kërkuar që ekipi i MKP-së urgjentisht të takoheshin në zyrën e tij për diskutime dhe nuk e lejoi më tej vizitën. Ai po ashtu e mohoi kërkesën e ekipit për qasjes në dosjen e personit të gjinisë femërore (V. K.).

Avokati i Popullit ua rikujton institucioneve nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ku theksohet: “*Çdo organ, institucion ose autoritet tjeter, që ushtron pushtet legitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuar në*

pajtim me ligjin." Në nenin 17 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit theksohet: "Avokati i Popullit vepron si Mekanizëm Kombëtar për Parandalim të torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese." Paragrafi 2.1 i këtij nenii thekson qartë se MKP-ja e Avokatit të Popullit është e obliguar "të vizitojë rregullisht dhe pa paralajmërim të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, duke përfshirë ndalimin policorë, paraburgimin, qëndrimin në institucionet shëndetësore, ndalimin doganorë, ndalimin e emigracionit dhe çdo vend tjetër ku dyshohet se ka shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut."

Neni 25, paragrafi 2, i Ligjit për Avokatin e Popullit, lidhur me detyrimin e bashkëpunimit dhe pasojat e refuzimit, theksohet qartë: "Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose nga autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga organi kompetent fillimin e procedurës administrative duke përfshirë marrjen e masave disiplinore, deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil." Në po të njëtin nen, në paragafin 3, theksohet si në vijim: "Në rastin kur institucioni refuzon të bashkëpunojë ose ndërhyjnë në procesin e hetimit, Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë nga prokuroria kompetente fillimin e procedurës ligjore, për pengimin e kryerjes së detyrës zyrtare."

Gjithashtu edhe në nenin 30 të Ligjit nr. 05/L-025 për Shëndetin Mendor përcaktohet: "Avokati i Popullit, nëpërmjet mekanizmave të tij, vëzhgon rregullisht me anë të inspektimeve periodike, respektimin e të drejtave dhe të standardeve që u ofrohen personave me çrrregullime mendore në mjediset e shërbimit të shëndetit mendor." Një veprim i tillë i drejtorit të IPFK-së, siç u theksua më lart bije në kundërshtim të plotë me dispozitat kushtetuese e ligjore dhe mund të përbëjë shkas që Avokati i Popullit të veproi mbi bazën e dispozitave të nenit 25, paragrafi 2, të Ligjit për Avokatin e Popullit.

Instituti i Psikiatrisë Forenzyke

1. Instituti i Psikiatrisë Forenzyke (IPFK) është hapur në gusht të vitit 2014. Aktualisht është nën menaxhimin e ShSKUK-së. Në bazë të Ligjit për Shëndetin Mendor, IPFK-ja është njësi organizative e ShSKUK-së. Sipas ligjit në fuqi, ofron shërbime të nivelit tertiar për tërë vendin (i vetmi në Kosovë).¹ Dispozitat ligjore përkatëse në lidhje me psikiatrinë forenzyke janë të përfshira në Kodin Penal (nenet 18 dhe 85), në Kodin e Procedurës Penale (KPP) (nenet 506 deri 518), dhe në Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (LESP) (nenet 169, 170, 171, 175).
2. Lidhur me statusin ligjor të IPFK-së, Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), në raportin e fundit të publikuar në gusht të vitit 2018², i kishte rekomanduar Ministrisë së Shëndetësisë (MSh): "*Të njoftohet MKP-ja e Avokatit të Popullit lidhur me çështjen e statusit ligjor të IPFK-së.*" Për këtë rekomandim, Institucioni i Avokatit të Popullit kishte marrë përgjigje nga ShSKUK-ja: "*Çështja e statusit ligjor të pazgjidhur të IPFK-së, ka qenë në diskutim me institucionet relevante e në veçanti të MSh, me kompletimin e Ligjit për Shëndetin Mendor si dhe plotësim ndryshimin e Ligjit për Shëndetësi nuk është në kompetencë të SHSKUK-së.*" Ne si MKP, Raportin e kemi dërguar edhe te MSh-ja, por nuk kemi pasur asnjë reagim deri më tanë.

¹ Ligji nr. 05/L-025 për Shëndetin Mendor, nisi 13, paragrafi 1.2.

² Shih raportin me rekomandime për IPFK-në: <https://oik-rks.org/2018/08/28/raporti-nga-vizita-ne-institutin-e-psikiatrise-forenzyke/>

3. Gjithashtu edhe KPT-ja, në raportin e fundit për Kosovën (publikuar më 23 shtator 2021)³, kishte potencuar se ende ekzistonte një mungesë e qartësisë në lidhje me statusin ligjor të IPFK-së, gjë që sipas përfaqësuesve të IPFK-së, e pengon ndjeshëm funksionimin e duhur dhe se ky institucion më së paku i takon ShSKUK-së. Lidhur me këtë çështje, *MKP-ja do të vazhdojë të kërkojë përgjigje nga MSh-ja dhe nga institucionet e tjera relevante.*
4. Kapaciteti i këtij institucioni është 36 shtretër (nga 12 shtretër në secilin repart). Sipas vlerësimit të drejtuesve të institucionit, numri i shtretërve nuk mjafton për tërë vendin. IPFK-ja përbëhet nga Reparti A (Pranimi/pacientët jo të shtrirë, shërbimet ambulatore); Reparti B (Trajtimet e detyrueshme psikiatrike); Reparti C (Vlerësimet psikiatrike); dhe Reparti D i risocializimit. Ministria e Shëndetësisë, gjegjësisht ShSKUK-ja, është përgjegjëse për repartet A, B dhe D. Shërbimi Korrektues i Kosovës (ShKK) është përgjegjës për menaxhimin dhe sigurinë në Repartin C. Në Repartin C janë të vendosur pacientët të cilët sillen nga ShKK-ja, të cilët janë të paraburgosur, kur gjykata kërkon vlerësimin e gjendjes mendore (ekspertizë psikiatrike), ose të dënuar të cilët sillen për trajtim nga burgjet. Në Repartin B janë të vendosur pacientët të cilëve gjykata ua ka shqiptuar masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucion.

Kushtet e jetesës

5. Kushtet materiale në IPFK ishin deri diku të mira. Dhomat janë me nga dy shtretër, pacientët kanë qasje në dritë natyrale, ventilim. Vlen të ceket se inventari ishte i demoluar, sidomos në pjesën e qëndrimit ditor - divanet, ishin shumë të dëmtuara. Kishte televizor, lojëra (shahu) si dhe hapësirë të përbashkët për kuzhinë. Ekipi gjatë vizitës vërejti se në dhomat e pacientëve dollapët ishin të demoluar. Në Repartin B, kur të lëshohen klimat, pikon ujë në korridore, në një dhomë në Repartin B kishte lagështi, dyshekët në përgjithësi nuk janë të mirë, dyert e dhomave nuk janë të sigurta dhe janë me xhamë transparentë. Privatësia në dushe dhe në tualete ishte në nivelin e duhur.
6. Për sa u përket dhomave të izolimit në Repartin C, nuk i plotësojnë kushtet, pasi gjatë kohës me shi pikon ujë nga tavani. Gjatë kohës së vizitës, ekipi vërejti se kamerat nuk punonin, xhami i derës së dhomës ishte i thyer. Dy dhomat e izolimit në Repartin C, për shkak të kushteve jo të mira, janë jashtë funksionit. Sipas informatave të siguruara nga stafi, kërkësen për rregullimin e kamerave të sigurisë e kanë drejtuar në ShSKUK, ku u është aprovuar kërkesa, mirëpo kërkesa për furnizim me dyshekë cilësorë nuk u është aprovuar nga ShSKUK-ja, ndërsa për kërkësen për renovim nuk kishin pranuar asnjë përgjigje deri në kohën e vizitës nga MKP-së. Avokati i Popullit kërkon që autoritetet kompetente të marrin masa për t'i evituar mangësitë për sa u përket kushteve të akomodimit, në mënyrë që ato të janë në pajtim me standardele nacionale dhe me ato ndërkombëtare.
7. Pjesa ku realizohen vizitat familjare në Repartin C ishte një dhomë shumë e vogël pa dritarë, e erret, me një tavolinë me dy karrige dhe privatësia nuk ishte në nivelin e duhur. Hapësirat e vizitave në të gjitha repartet janë në korridore, pa dyer, ku nuk sigurohet privatësia dhe janë të vrazhda, si për pacientin po ashtu edhe për familjarin.

³ Shih raportin, <https://www.coe.int/en/web/cpt/-/the-cpt-publishes-report-on-kosovo>.

8. Vizitat familjare realizohen dy herë në javë nga 30 minuta. Përpos vizitave, pacientët kanë të drejtë edhe për telefonata. IPFK-ja i praktikon edhe vikendet terapeutike, gjë e cila deri më tani është treguar e suksesshme. **MKP-ja nuk ka marrë ankesa nga pacientët për kontakt me botën e jashtme.**
9. Gjatë vizitës së fundit nga MKP-ja (shtator 2022), në secilin repart kapaciteti ishte i plotësuar. Sipas drejtorit, kapaciteti të total është për 36 shtretër, ndërsa aktualisht me dosje ishin rrëth 40 pacientë, mirëpo disa ishin në vikend terapeutik. Në listë të pritjes për këto reparte i kanë edhe disa raste të tjera. Gjatë vizitës, në Repartin B ishte e pranishme edhe një paciente, e cila ishte e akomoduar në njérën nga dhomat e Repartit B, por jo e ndarë nga gjinia mashkulllore. Nga pacientja V. K. kemi marrë ankesë se pse po trajtohet në institucion të mbyllur për gati 3 muaj, e cila potencoi se përpëra është trajtuar në reparte të hapura në psikiatri. Ajo nuk ndihej rehat në atë dhomë duke e ditë se në atë repart janë edhe 11 pacientë të gjinisë mashkulllore, pasi sipas ankueses, edhe xhamat e dyerve të dhomës janë transparentë. Gjithashtu kishte ankesë se nuk i lejohej në dhomë letër tualeti.
10. Lidhur me shqetësimet e ankueses, ekipi monitorues bisedoi me drejtorin e IPFK-së, nga i cili u njoftu se për këtë paciente janë arritur objektivat e trajtimit në IPFK. Andaj drejtori i IPFK-së pohon se e ka njofuar gjyqtarin e çështjes lidhur me arritjen objektive të kësaj pacienteje si dhe ka kërkuar ndryshimin e masës, mirëpo ende nuk ka marrë përgjigje nga gjykata. Drejtori potencoi se ende mbetet sfidë për IPFK-në vonesa e gjykatave në trajtimit e këtyre rasteve kur arrihen suksesshiem objektivat e trajtimit në IPFK.
11. Përfaqësuesja e IAP-së, përmes shkresës zyrtare, ka kontaktuar me gjyqtarin e rastit në Gjykatën Themelore në Prishtinë (GjThP) lidhur me pohimet e drejtorit të IPFK-së. Në të njëjtën ditë përfaqësuesja e IAP-së, përmes shkresës zyrtare, është njofuar nga gjyqtari i çështjes se rasti është trajtuar si dhe i është ndërruar masa nga *Masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik* në *Ndalim* në masë të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri.
12. MKP-ja shpreh shqetësim se IPFK-ja nuk ka një repart të veçantë për pacientet dhe për të mitur. Pasi IPFK-ja nuk ka hapësira adekuate për gjininë femërore dhe për të miturit, pacientët e gjinisë mashkulllore dhe femërore rrinë në hapësira të përbashkëta. Edhe gjatë vizitës nga MKP-ja u vërejt se edhe rutina e shëtitjes në repartet B, D u ndryshon, p.sh. Reparti D, për shkak se nuk kishin qasje të drejtëpërdrejtë në oborr, e ka të kufizuar deri në 2 orë në ditë shëtitjen. Gjithashtu edhe në Repartin C, nëse e sjellin ndonjë femër apo të mitur, bllokohen dy dhoma me nga dy shtretër për shkak të infrastrukturës së papërshtatshme, kurse gratë e vendosura në Repartin C kishin qasje të kufizuar për dalje në natyrë pasi ato mund të dilnin në oborr vetëm kur pacientët meshkuj ishin brenda. **MKP-ja e Avokatit të Popullit kërkon nga autoritetet kompetente që sa më shpejt të ndërmarrin masa në rritjen e kapaciteteve dhe krijimin e kushteve për pacientët e të dy gjinive si dhe për të miturit, në mënyrë që t'u mundësohet pacientëve të përfitojnë në mënyrë efektive nga qasja në mjediset e jashtme, çdo ditë (me mbikëqyrjen e duhur dhe/ose siguri nëse kërkohet).**

Keqtrajtimi

13. MKP-ja gjatë vizitës nuk mori ankesa për keqtrajtim fizik, mirëpo as nuk vërejti shenja të dhunës fizike tek pacientet. Ekipi intervistoi pacientët e pranishëm, të cilët pohuan për një trajtim të duhur nga stafi mjekësor.

14. IPFK-ja tani posedon Regjistrin e Aktiviteteve Sociale, Regjistrin e Aktiviteteve Psikologjike. Ndërsa në një regjistër i shkruajnë incidentet, vetëlëndimet dhe masën e izolimit. Incidentet e dhunshme (përfshirë ato me përdorim force nga stafi i sigurisë) nuk regjistrohen në ndonjë regjistër të veçantë. Sipas stafit, ndonjëherë mund të ketë keqkuptime në mes të pacientëve, mirëpo në vitet e fundit nuk ishte evidentuar asnjë incident. MKP-ja kërkon nga IPFK-ja që t'i kushtojë rëndësi evidentimit të incidenteve të dhunshme, përfshirë edhe përdorimin e forcës nëse përdoret ndonjëherë, si dhe t'i regjistrojnë në regjistra të veçantë incidentet dhe masën e izolimit.

Trajtimi dhe aktivitetet

15. Në IPFK, përveç vlerësimit, trajtimit me medikamente, ofrohen edhe aktivitete psiko-social. Trajtimi psiko-social konsiston në aktivitetet, si: lojëra, shikim televizori, vizatime, daljet ditore brenda institucionit (në shëtitore të IPFK-së), seanca individuale dhe grupore me psikologun etj. Orari i aktiviteteve ditore ishte i vendosur në vende të dukshme, por ky orarë është uniform.
16. Gjatë vizitës nga MKP-ja, ekipi vërejti një arritje lidhur me aktivitetet psiko-sociale, të cilat evidentohen në regjistra të veçantë, si: Regjistri i Aktiviteteve Sociale dhe Regjistri i Aktiviteteve Psikologjike. Për më tepër, MKP-ja vërejti se shumica e pacientëve kishin plane individuale të trajtimit. MKP-ja ndër vite ka vërejtur se trajtimi në thelb është me farmakoterapi. Në raportin e fundit të MKP-së së Avokatit të Popullit, i publikuar në gusht 2018, përvizitën në IPFK, ishte potencuar: “*Është përgjegjësi e institucionit dhënia e medikamenteve të caktuara sipas evidencave të njohura por edhe aplikimi i monitorimit të efekteve anësore të tyre të mundshme sipas praktikave të pranuara klinike (analizat përcjellëse tek aplikimi i Clozapinës).*”
17. Në raportin e fundit të KPT-së për Kosovën (publikuar më 23 shtator 2021)⁴, sipas gjetjeve të tyre, trajtimi konsiston në farmakoterapi dhe se planet individuale të trajtimit nuk ishin hartuar sistematikisht dhe nuk kishte regjistrim të duhur të vlerësimit dhe progresit në dosjet mjekësore të pacientëve. Sipas tyre, dosjet e pacientëve, të shikuara nga delegacioni, ishin elementare, pa asnjë informacion për historinë mjekësore (zhvillimi i simptomave, trajtimi i mëparshëm dhe rezultatet, tiparet e veçanta të personit ose sëmundja) dhe mungonte përrshkrimi i situatës sociale të pacientit. Për më tepër, diagozat dhe trajtimi i pacientëve nuk ishin të arsyetuara siç duhet. MKP-ja inkurajon stafin e IPFK-së që t'u japid rëndësi rekondimeve të KPT-së lidhur me farmakoterapinë dhe qasjen shumëdisiplinore. Shih Raportin e KPT-së për Kosovën, paragrafet 131, 132⁵.

Shërbimet mjekësore

18. Bazuar në vizitat e rregullta të MKP-së në burgje, kemi pranuar shqetësimet nga mjekët e burgjeve, e sidomos duhet potencuar Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë, lidhur me rastet që janë me vendim të gjykatës për ekzaminim psikiatrik në IPFK, në mungesë të vendeve të lira në IPFK, kthehen prapë në qendra të paraburgimit, ato raste kthehen vetëm me një letër, ku shkruhet: “*Nuk ka vend të lirë*”. MKP-ja gjatë vizitës së fundit e ka

⁴ Shih raportin, <https://www.coe.int/en/web/cpt/-/the-cpt-publishes-report-on-kosovo>.

⁵ Po aty. Paragrafi 131, 132

adresuar këtë çështje te drejtori i IPFK-së dhe, sipas tij, për shkak të kapaciteteve të mbushura - të mbipopulluara, rastet kthehen përsëri, mirëpo të paktën mjekët në IPFK ofrojnë trajtim ambulator dhe terapi.

Konfidencialiteti i shërbimeve mjekësore

19. MKP-ja gjatë vizitës vërejti se shërbimet mjekësore pacientëve në IPFK u jepen pa praninë e zyrtarëve të sigurimit, përvèç nëse personeli mjekësor në raste të caktuara shprehimisht e kërkon një gjë të tillë.

Parandalimi i vetëvrasjeve

20. Sipas pohimeve të stafit, përgjatë viteve të fundit nuk kanë pasur raste të vdekjeve apo vetëvrasjeve në IPFK. Në Raportin e fundit të IAP-së për vizitën në IPFK, i publikuar në gusht 2018, ishte potencuar se IPFK-ja nuk kishte ndonjë plan parandalues specifik lidhur me vetëvrasjet. Gjatë vizitës së fundit nga MKP-ja u vërejt se është zbatuar ky rekomandim. IPFK-ja së fundmi kishte përpiluar: *Protokollin e vlerësimit dhe trajtimit të pacientëve që shfaqin rrezik potencial për vetëvrasje; Protokollin e parandalimit dhe menaxhimit të sjelljes së çregulluar/violente dhe Protokollin e vlerësimit dhe trajtimit të pacientëve që shfaqin sjellje vetëlenduese*. Këto protokolle janë verifikuar edhe nga ekipi i MKP-së.

Mjetet e kufizimit

21. MKP-ja gjatë vizitës vërejti se nuk përdoret kufizim mekanik. Në repart është një këmishë për fiksim mekanik, por nuk është përdorur asnjëherë. Dhoma e izolimit është mjeti kryesor dhe i vetmi mjet i kufizimit. Gjatë vizitës MKP-ja vërejti formularin e monitorimit të izolimit, ku stafi, pas monitorimit, çdo 15-30 minuta e nënshkruan formularin në fjalë. MKP-ja analizoi formularin e izolimit i quajtur “*Forma e monitorimit të izolimit*”, në të cilën shkruhen detajet, si: emri, mbiemri i pacientit, arsyaja e izolimit, forma e izolimit, data, koha kur është futur në izolim, situatën e pacientit, nënshkrimi i mjekut që e ka dhënë urdhrin për izolim, koha dhe data për të filluar me ilaçet “antithrombotike” si dhe kolonat ku shkruhet koha e monitorimit. Pas përfundimit të masës së izolimit, formulari futet në dosjen e pacientit.
22. MKP-ja e Avokatit të Popullit, edhe në raportin e fundit, i publikuar më 28 gusht 2018, e kishte adresuar problematikën se përdorimi i dhomave të izolimit ishte i tepruar dhe me kohëzgjatje që nuk mund të arsyetohej. MKP-ja e Avokatit të Popullit vërejti se ende nuk ka protokoll specifik për përdorimin e mjetave të kufizimit për institucionet psikiatrike, ashtu siç kërkohet sipas nenit 27 të Ligjit për Shëndetin Mendor, paragrafët 2 dhe 3.
23. Edhe KPT-ja, në raportin e fundit për vizitën në Kosovë, lidhur me Institutin e Psikiatrisë Forenzyke të Kosovës (IPFK) dhe Klinikën Psikiatrike, kishte theksuar se izolimi i pacientëve ishte një praktikë e shpeshtë, zakonisht e kombinuar me administrimin me forcë të ilaçeve (me përbajtje kimike). KPT-ja kujton se përdorimi i mjetave të kufizimit duhet të jetë subjekt i një politike gjithëpërfshirëse dhe kishte dërguar një numër rekomandimesh specifike në këtë drejtim.⁶

⁶ Shih raportin e KPT-së për vizitën e fundit në Kosovë, paragrafët 139, 140: <https://www.coe.int/en/web/cpt/-/the-cpt-publishes-report-on-kosovo>.

Stafi në IPFK

24. Aktualisht janë 8 mjekë (6 prej tyre psikiatër, 2 psikiatër forenzikë), 2 psikologë klinikë, 2 punëtorë socialë, 22 infermierë dhe stafi mbështetës (personeli administrativ, personeli i kuzhinës, lavanderisë si dhe personeli i sigurimit të brendshëm).
25. Stafi vetëm në fillim ka pasur një trajnim bazik kapje/kontrolle për menaxhimin e rasteve të vështira dhe asnjëherë tjetër nuk janë realizuar trajnime të tillë për stafin. Gjatë vizitës së fundit MKP-ja u njoftua se stafi shëndetësor i IPFK-së i ka dhënë informata bazike personelit të sigurisë së brendshme se si t'i menaxhonë rastet në krizë. MKP-ja inkurajon IPFK-në që personeli shëndetësor si dhe ai i sigurisë, i cili i ndihmon stafit mjekësor në menaxhimin e situatave të krizave, të realizojnë trajnime profesionale dhe adekuate për punë me këtë kategori të pacientëve.

Rishikimi i vendimeve nga gjykatat kompetente

26. MKP-ja u informua se po vazhdon problemi i njëjtë, ku drejtori i IPFK-së pretendon se problem shtesë përbën mosndryshimi i mësës nga gjykatat kompetente, pavarësisht arritjes së objektivave për trajtim të atyre rasteve. Sipas njoftimit të drejtorit të IPFK-së, kanë bërë kërkesë për disa persona që t'iu ndërrrohet masa, por nuk kanë marrë përgjigje nga gjykatat. Gjithashtu u potencuan problemet me të cilat po ballafaqohen institucionet e shëndetit mendor, që rastet që vijnë me vendim të gjykatës për trajtim të detyrueshëm me ndalim, ndodh që nuk i plotësojnë kriteret për këtë trajtim dhe se kjo nuk po ndikon mirë në gjendjen e përgjithshme shëndetësore dhe duke e renduar gjendjen e shëndetit mendor.
27. Edhe në Raportin e fundit të IAP-së, i publikuar në gusht të vitit 2018, ishte konstatuar se IPFK-ja, bazuar në kërkesën e gjykatës kompetente, në baza të rregullta kishte dërguar raporte relevante mjekësore në të cilat ishte vlerësuar gjendja shëndetësore e pacientit të pranuar. IPFK-ja në baza të rregullta gjashtëmujore bën rishikimin e gjendjes shëndetësore të pacientit, për çka e njofton gjykatën, mirëpo, pavarësisht njoftimit dhënë gjykatës përaportet rishikuese të gjendjes shëndetësore të përmirësuar të pacientit, sipas pohimeve të personelit mjekësor të IPFK-së, gjykatat nuk i marrin përbazë raportet e institucionit shëndetësor dhe nuk u kthejnë përgjigje.
28. MKP-ja vëren se nen 85, paragrafi 2, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës shprehimisht përcakton se gjykata do ta pushojë masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik pasi ta ketë vërtetuar se ka pushuar nevoja për trajtim në institucionin e kujdesit shëndetësor. Ndërsa nen 171 i Ligjit nr. 08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, paragrafi 3, përcakton: “*Çdo gjashtë (6) muaj, gjykata që ka caktuar masën në shkallë të parë, e shqyrton nevojën e vazhdimit të masës pas shqyrtimit të institucionit shëndetësor dhe të mendimit të ekspertit të pavarur, i cili nuk është i punësuar në institucionin e kujdesit shëndetësor ku është duke u ekzekutuar masa.*”
29. Lidhur me këto probleme, IAP-ja në fund të vitit 2021 kishte realizuar tryeza diskutimi me gjyqtarë, me prokurorë, me psikiatër nga të gjitha institucionet e shëndetit mendor, me qëllim që ta zhvillonin një dialog ndërinstitucional, për t'i kuptuar sfidat e njëri-tjetrit dhe në kuptim të të drejtave të atyre që vendosen në trajtim të pavullnetshëm apo të detyrueshëm.
30. Edhe delegacioni i KPT-së, në vizitën e fundit që e kishte realizuar në Kosovë gjatë tetorit 2020, kishte potencuar se kishte analizuar dosjet individuale të pacientëve

forenzikë dhe kishte vënë re se kishte mbetur praktikë e gjykatave që të shqyrtonin vendosjet për këto raste çdo gjashtë muaj. Megjithatë, sipas KPT-së, është për të ardhur keq që mangësitë e theksuara në raportet e mëparshme të KPT-së nuk ishin marrë parasysh dhe ende po vazhdonin. Sipas gjetjeve të KPT-së, përderisa raportet dërgoheshin nga IPFK-ja në gjykata çdo gjashtë muaj, siç parashikohej nga LESP-ja, ato zakonisht përbënbanin një tekst të ngjashëm standard. Mendimi i një eksperti të pavarur (plotësues i vlerësimit mjekësor të institucionit) nuk ishte urdhëruar sistematikisht nga gjykata. Për më tepër, pacientët forenzikë nuk ishin në dijeni të të drejtave të tyre procedurale dhe nuk merrnin pjesë në seancat dëgjimore kur gjykata e konsideronte të nevojshme vetëm në rast të pushimit të masës (d.m.th. për lirim ose shndërrim të masës në trajtim të detyrueshëm ambulator psikiatrik).

31. KPT-ja në raportin e fundit kishte theksuar sërisht se çdo rishikim i detyrueshëm i masës (do të thotë të paktën çdo gjashtë muaj) duhet të përfshijë jo vetëm një raport me shkrim nga institucioni i kujdesit shëndetësor dhe mendimin e një eksperti të pavarur (siç kërkohet me legjislacionin kombëtar), por edhe një seancë dëgjimore ku dëgjohet avokati mbrojtës dhe pacienti. **Institucioni i Avokatit të Popullit inkurajon institucionet relevante që këto praktika të ndryshohen bazuar në vërejtjet e KPT-së.**
32. MKP-ja ndër vite ka vërejtur se nuk ka evidenca që është ofruar shpjegim me shkrim për arsyet e trajtimit të pavullnetshëm, ashtu siç parashihet në nenin 21, paragrafi 1.4, të Ligjit për Shëndetin Mendor, i cili shprehimisht përcakton se pacientit të trajtuar pa vullnetin e tij/saj, ndër të tjera, duhet t'i shpjegohen me shkrim, brenda 48 orëve, arsyet e trajtimit të pavullnetshëm.
33. Për sa i përket së drejtës për trajtim, e njëjta situatë ishte konstatuar edhe në raportin e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës për vizitën në Kosovë në vitin 2015⁷, 2020⁸, ku në të shumtën e rasteve pacientëve nuk u jepet mundësia e dhëniaj se pëlqimit me shkrim apo e drejta për refuzim të trajtimit.
34. MKP-ja vëren se edhe në raportin e fundit të KPT-së ishte vënë theksi te pëlqimi për hospitalizim dhe pëlqimi për trajtim, të cilat janë dy çështje të ndryshme. Sipas KPT-së, si parim i përgjithshëm, të gjitha kategoritë e pacientëve psikiatrikë, p.sh. vullnetarë ose jovullnetarë, të natyrës civile ose forenzike, me zotësi juridike ose me paaftësi juridike, duhet të vihen në një pozicion ku mund të japid pëlqimin e tyre të lirë dhe të informuar për trajtimin. Është aksiomatike që pëlqimi për trajtimin mund të cilësohet si i lirë dhe i informuar vetëm nëse bazohet në informacione të plota, të sakta dhe të kuptueshme për gjendjen e pacientit, trajtimin që propozohet dhe efektet e mundshme anësore të tij, si dhe për mundësinë e tërheqjes së pëlqimit. Më tej është thelbësore që të gjithë pacientët që kanë dhënë pëlqimin e tyre për trajtim të janë të informuar vazhdimisht për gjendjen e tyre dhe për trajtimin e aplikuar ndaj tyre dhe që ata të vihen në një pozicion që të mundë ta tërheqin pëlqimin e tyre në çdo kohë. Përveç kësaj, çdo pacient, i aftë për të gjykuar, duhet ta ketë të drejtën ta refuzojë një trajtim të caktuar ose çdo ndërhyrje tjetër mjekësore. Çdo shmangje nga ky parim themelor duhet të bazohet në ligj dhe të lidhet

⁷ Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, raporti për vizitën në Kosovë në vitin 2015, i publikuar në vitin 2016, paragrafi 101. Për më shumë: <https://rm.coe.int/16806a1efc> (4.7.2018).

⁸ Shih raportin e KPT-së, paragrafi 145, për vizitën e fundit në Kosovë, i publikuar më 23 shtator 2021: <https://www.coe.int/en/web/cpt/-/the-cpt-publishes-report-on-kosovo>.

vetëm me rrethana të jashtëzakonshme të përcaktuara në mënyrë të qartë dhe të rreptë dhe duhet të shoqërohet me masa mbrojtëse të përshtatshme.

Procedura e parashtrimit të ankesave

35. Procedura efektive për parashtrim të ankesave është garanci themelore kundër keqtrajtimit në institucionet psikiatrike. Duhet të ekzistojnë aranzhime specifike për t'ua mundësuar pacientëve parashtrimin formal të ankesës dhe të jenë në gjendje të komunikojnë me autoritetin e duhur jashtë institucionit në mënyrë konfidenciale.
36. Gjatë vizitës, MKP-ja vërejti se në Psikiatrinë Forenzike dhe në reparte të Klinikës Psikiatrike ekzistojnë kutitë e ankesave për pacientë, të cilat nuk ishin të etiketuara siç duhet, e që sipas drejtorisë, ato kuti hapen nga një zyre përgjegjëse në kuadër të QKUK-së. Megjithatë, për MKP-në është e paqartë procedura e parashtrimit të ankesës së pacientit, nga kush hapen ato kuti, kush i trajton ankesat. Pra MKP-ja kërkon nga ShSKUK-ja ta njoftojë me shkrim lidhur me këtë çështje. Në këtë drejtim, përfaqësuesi i MKP-së i është drejtuar me email ShSKUK-së për t'i kërkuar informata, mirëpo ende nuk ka kthyer përgjigje.
37. MKP-ja, në raportin e fundit të publikuar më 28 gusht 2018, kishte rekomanduar që të instalohej në IPFK sistemi (një kuti ankesash) i cili ua mundëson pacientëve që menaxhmentit t'ia drejtojnë ankesat e tyre në mënyrë konfidenciale dhe në këtë kuti të ketë qasje vetëm personeli i caktuar. Njëkohësisht, pacientët të njoftohen (për aq sa është e mundur) për këtë të drejtë dhe për procedurat e ankesës.
38. Në bazë të të gjeturave dhe të konstatimeve të MKP-së gjatë vizitës, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 17, paragrafi 7, të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit:

REKOMANDON

Ministrisë së Shëndetësisë:

- *Të krijohet protokoli specifik për përdorimin e mjeteve të kufizimit për institucionet psikiatrike, siç kërkohet sipas nenit 27 të Ligjit për Shëndetin Mendor.*

Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës

- *Të kryhen rinovimet e nevojshme brenda Institutit të Psikiatrisë Forenzike të Kosovës, në mënyrë që kushtet të jenë në pajtim me standarde nationale dhe ndërkombëtare.*
- *Avokati i Popullit ripërsërit rekomandimin që në Institutin e Psikiatrisë Forenzike të Kosovës të vendoset një kuti për ankesa, e cili ua mundëson pacientëve që menaxhmentit t'ia drejtojnë ankesat në mënyrë konfidenciale dhe në këtë kuti të ketë qasje vetëm personeli i caktuar. Njëkohësisht, pacientët të njoftohen (për aq sa është e mundur) për këtë të drejtë dhe për procedurat e parashtrimit të ankesës.*


Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Drejtësisë:

- *Avokati i Popullit ripërsëritë rekomandimin që MKP-ja e Avokatit të Popullit të njoftohet lidhur me çështjen e statusit ligjor të Institutit të Psikiatrisë Forenzike të Kosovës.*
- *Autoritetet të ndërmarrin masa për rritjen e kapaciteteve dhe krijimin e kushteve për pacientët e të dy gjinive, si dhe për të miturit.*

- Personeli shëndetësor i Institutit të Psikiatrisë Forenike të Kosovës si dhe ai i sigurisë, i cili i ndihmon stafit mjekësor në menaxhimin e situatave të krizave, të realizojnë trajnime profesionale dhe adekuate për punë me këtë kategori të pacientëve.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“*Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuar në pajtim me ligj*”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“*Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshire edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë*”), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,


Naim Qelaj

Avokat i Popullit